



CRÉDIT AGRICOLE S.A.
PROJEKTI NËN EMBARGO DERI TË ENJTEN, 7 AM, DATË 6 NËNTOR
2014

Montrouge, 6 Nëntor 2014

Rezultatet për tremujorin e tretë dhe nëntë mujorin e parë 2014

Fuqia e konfirmuar e Grupit Crédit Agricole

- Moment i mirë i biznesit

- Rënia e vazhdueshme në koston e riskut**
- Raportet e aftësisë paguese të përforcuara më tej**
- Grupi Crédit Agricole ka kaluar me sukses AQR / Stress Testin**

Grupi Crédit Agricole*

Pjesa e Fitmit Neto të Grupit T3-14: 1,463 milion euro (+2.1% nga viti në vit)

Pjesa e Fitmit Neto të Grupit 9 mujori 2014: 3,588 milion euro (-6.6 % nga viti në vit)

Duke përfshirë impaktin e BES në tremujorin e dytë të 2014 për -708 milion euro

Plotësisht i ngarkuar Basel 3 rap.CET1, datë 30 Shtator 2014:12.9% (+ 153pb gjatë 9 muajve)

* Crédit Agricole S.A dhe 100% e Bankave Rajonale

Crédit Agricole S.A.

Të ardhurat neto të aksioneve të Grupit T3-14: 758 milion euro (+4.1% nga viti në vit)

Qëndrueshmëria e të ardhurave të linjave të biznesit: -0.9 % nga viti në vit)**

Kostot nën kontroll

Ulja e koston së riskut të linjave të biznesit: -19.0 % nga viti në vit

Pjesa e Fitmit Neto të Grupit për 9 mujorin 2014: 1,643 milion euro (-13.2% nga viti në vit)

Duke përfshirë impatin BES në tremujorin e dytë të 2014 për -708 milion euro

Plotësisht i ngarkuar Basel 3 rap.CET 1, datë 30 Shtator 2014: 10.1% (+160 pb gjatë 9 muajve)

**përfshirë DVA e vazhdueshme dhe mbrojtjen e kreditë

Grupi Crédit Agricole

Bordi drejtues i Crédit Agricole SH.A, me në krye Jean-Marie Sander, u mbledh më 5 Nëntor 2014 për të ekzaminuar pasqyrat financiare për 3 mujorin e tretë dhe nëntëmujorin e parë të 2014.

Bordi filloi me analizimin e rezultateve të shqyrtimit gjithëpërfshirës të BQE të bilanceve të Bankës Europiane. Për Jean-Marie Sander, Kryetar i Crédit Agricole SH.A, rezultatet e këtij shqyrtimi janë pozitive për Grupin, i cili mund të përballojë stresse të vështira pa kërkesë shtesë të kapitalit. Teprica e kapitalit mbi pragun e përcaktuar nga BQE e vendos Grupin përkrah bankave më të fuqishme në eurozonë. Rezultati i Vlerësimit të Cilësisë së Aseteve (AQR) ishte -0.18 % në raportin CET 1, duke konfirmuar fuqinë e strukturës financiare të Grupit.

Pjesa e fitimit neto të Grupit Crédit Agricole ishte 1,463 milion euro në tre mujorin e 2014, një rritje nga viti në vit prej 2.1%. Për nëntë mujorin e parë të vitit, një periudhë e cila përfshin impaktin e zgjidhjes BES, pjesa e fitimit neto të Grupit ishte në shumën e 3,588 milion euro.

Për Jean-Paul Chifflet, Kryeshefi Ekzekutiv i Crédit Agricole SH.A, kjo performancë e ngurtë është në linjë me tremujorin e mëparshëm. Ajo vjen nga rënia e vazhdueshme në koston e riskut dhe vazhdon me një moment të mirë të të gjitha linjave të biznesit, pavarësisht mjedisit të sfidave ekonomike, rregullatore dhe fiskale. Të ardhurat u rritën me 1.3 % nga viti në vit në tremujorin e tretë të 2014 dhe kostoja e riskut u ul me 17.1% gjatë të njëjtës periudhë.

Pas rritjes të të ardhurave dhe fitimit në 2013, sipas një baze të lartë për krahasim, Bankat Rajonale vazhduan të zhvillonin biznesin e tyre në një treg vazhdimisht të ngadaltë të prekur nga një mjedis ekonomik i zymtë dhe një klimë rregullatore e pafavorshme.

Asetet e klientit u rritën me 2.7% vit pas vit duke arritur në 596 miliard në fund të Shtatorit 2014, duke përfshirë 350 miliard euro në depozitat në bilance, të cilat u rritën me 3.0% vit pas viti. Asetet e bilanceve u rritën me 2.2% nxitur nga një rritje 4.3% vit pas viti në sigurimet e jetës të papaguara.

Kreditë e papaguara ishin në shumën e 400 miliard euro në fund të Shtatorit 2014, një rritje vit pas viti prej 0.7% nxitur kryesisht me rritje prej 2.3% në kreditë për shtëpi.

Bankat Rajonale arritën fitim neto prej 902 milion euro në tremujorin e tretë dhe 2,711 milion euro për nëntëmujorin e parë, me një rënie prej 2.6% dhe 2.0% respektivisht, vit pas viti. Kostoja e riskut arriti një ulje prej 10 pikë bazë nga vonesat, krahasuar me 19 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013, pjesërisht kompensimin e rënies të të ardhurave nga një bazë shumë e lartë në tremujorin e tretë të vitit 2013.

Gjatë tremujorit të tretë të 2014, struktura financiare e Grupit është fuqizuar ndjeshëm.

Në kushtet e paafësisë paguese, raporti Basel 3 i raportit të kapitalit Tier 1 ishte 12.9% në fund të muajit Shtator 2014, një rritje prej 153 pikë bazë që nga fillimi i vitit. Kjo rritje e madhe ishte drejtuar nga modeli i biznesit të Grupit (fitimet e mbajtura dhe riinvestimet e dividendëve), një rritje në fitimet e përealizuara, të njohura në kapitalin neto dhe vazhdimin e planit të biznesit të implementuar në tre vitet e fundit (dispozicionin e biznesit, uljen e asetëve të ponderuara me riskun)

Raporti me faza i levës për Grupin Crédit Agricole ishte 4.1% në fund të muajit Shtator 2014 në bazë CRD4 dhe 5.1 bazuar në metodologjinë e aplikueshme në vitin 2015 (akti i deleguar miratuar nga Komisioni European më 10 Tetor 2014).

Crédit Agricole SH.A.

Pjesa e Fitimit Neto të Grupit Crédit Agricole SH.A ishte 758 milion euro në tremujorin e tretë të vitit 2014, duke shënuar një rritje vit pas viti prej 4.1%.

Kjo rritje, në një mjedis ekonomik vazhdimisht të dobët, ishte për shkak të rezistencës së linjave të biznesit të të ardhurave, shpenzimet operative të qëndrueshme dhe një reduktim i vazhdueshëm në kostot e riskut të linjës së biznesit.

Në pakicën bankare Franceze, LCL ka mbajtur një gjendje të fortë në asetet e klientit, me një rritje prej 2.8% vit pas viti në depozitat e bilanceve dhe 4.7% rritje në sigurimin e jetës. Kreditë e papaguara u rritën me 1.3% të nxitura nga kreditë për shtëpi.

Asetet e menaxhuara nga linjat e menaxhimit të ruajtura dhe sigurimit të biznesit u rritën me 105 miliard euro vit pas vitit deri në 1,229 miliard euro. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2014, rritja ishte 85 miliard euro, duke përfshirë flukset neto prej 29 miliard euro.

Bankingu i investimeve dhe korporatave kontribuoi me një rritje të mirë në veprimtarinë financiare dhe një kontributi të qëndrueshëm nga biznesi i thesarit, i cili kompeson performancën e dobët nga tregjet e tjera kapitale dhe aktivitetet bankare të investimit, veçanërisht në muajin gusht.

Shpenzimet operative ishin të qëndrueshme krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Ulja e kostos së programit ka ndihmuar në përthithjen e rritjes së shpenzimeve lidhur me planin e transformimit të LCL, integrimi i subjekteve të reja në Amundi, si dhe taksat e reja në degët e sigurimit. Ruajtjet e kostove sipas programit MUST në shumën e 104 milion në nëntëmujorin e parë të 2014, duke sjellë një total prej 455 milion euro që nga fillimi i programit në vitin 2012. Objektivi i përgjithshëm është 650 milion euro në fund të 2016.

Ulja e kostos së riskut ka vazhduar gjatë tremujorit të tretë, me një ulje prej 8.0% vit pas viti. Kostoja e riskut ka rënë në 50 pikë bazë nga vonesat, 9 pikë bazë më pak se viti i kaluar. Kjo tendencë është veçanërisht e evidentuar në bankungun francez me pakicë, ku kostoja e riskut ishte 17 pikë bazë të LCL në krahasim me 25 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013. Në financën e konsumatorit, kostoja e riskut vazhdoi të ulët në degën Italiane Agos Ducato. Në aktivitetin financiar, kostoja e riskut mbeti shume e ulët me 30 pikë bazë. Bankingu ndërkombëtar me pakicë ishte një përjashtim, me një rritje në koston e riskut në Ukrainë dhe Itali.

Në nëntëmujorin e parë të 2014, pjesa e Fitimit Neto të Grupit ishte 1,643 milion euro, me një rënie prej 13.2% vit pas viti, një ulje tërësore e krizës të verës së kaluar të BES.

Fuqia financiare e Crédit Agricole ishte forcuar më tej, në ngarkim të plotë me raportin CET1 prej 10.1% në fund të muajit Shtator 2014 kundrejt 9.9% në fund të muajit Qershor 2014. Ky raport përfshin tashmë 1miliard euro për ndikimet e maturuara të vlerësimit, me një shtesë prej 300 milion euro të shtuara në tremujorin e tretë të 2014.

Raporti i fazës në total për Crédit Agricole SH.A ishte 19.2% në fund të muajit Shtator 2014, një rritje prej 360 pikë bazë që prej fillimit të vitit.

Përgjegjësia sociale dhe mjedisore

Grupi Crédit Agricole ka afirmuar angazhimin e tij për luftën ndaj ndryshimit të klimës dhe ai gjithashtu po merr një numër iniciativash për të mbështetur rritjen ekonomike të uljes së karbonit.

Në Samitin e OKB mbi klimën të mbajtur më 23 Shtator, Jean-Yves Hoher, Zëvendës Shefi Ekzekutiv i Crédit Agricole SH.A dhe Shefi Ekzekutiv i Crédit Agricole CIB prezantuan katër masat e marra për tu implementuar nga Grupi dhe veçanërisht anën e korporatës dhe investimit banker. Këto masa janë: vendosja e më shumë se 20 miliard dollar për financimin e ri të “green” në fund të 2015; matja dhe publikimi i gjurmëve të karbonit të aktiviteteve financiare të CIB; përfshirja e kriterëve sociale dhe mjedisore në politikat e sektorit të financimit në masën prej më shumë se 80% të kësaj gjurme në total; dhe propozimi i partnerëshipeve të reja me sektorin publik për të financuar luftën kundër ndryshimeve klimaterike.

Ndërkohe, Amundi ka nisur një gamë të re të produkteve në Indeksin e Liderëve Global të Uljes së Karbonit MSCI në partneritet me “Fonds de Réserve pour les Retraites” (FRR) dhe fondi i pensioneve Suedeze AP4. Këto indekse përbëhen nga kompanitë me ekspozim më të ulët të karbonit se mesatarja e tregut. Kjo gamë produktesh është e para për tju adresuar të dyja dimensioneve të ekspozimit të riskut të karbonit-emetimet e karbonit dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë fosile.

Këto veprime kontribuojnë në forcimin e Grupit Crédit Agricole si dhe performancës së Korporatës për Përgjithësitë Sociale (CSR). Crédit Agricole SH.A, e cila përfshihet në pesë treguesit CSR-FTSE4 Good, Indeksi i Liderve NYSE Euronext Global ESG , e cila bën bashkë një përzgjedhje të kompanive me performancën më të mirë në kushtet e kriterëve mjedisore, sociale dhe qeverisëse (ESG). Agjensia e vlerësimit extra-financiare e rendit Grupin të 13tën nga 221 grupe bankare në mbarë botën. Grupi përmirësohet në të gjitha zonat ESG dhe është tani ndër liderët të industrisë, psh. Në 5% e kompanive më të vlerësuara.

Kalendari Financiar

18 Shkurt 2015	Publikimi i tremujorit të katërt dhe rezultateve të plota të vitit 2014
6 Maj 2015	Publikimi i rezultateve të tremujorit të parë të 2015
20 Maj 2015	Mbledhja Vjetore e Aksionerëve
4 Gusht 2015	Publikimi i rezultateve të tremujorit të dytë të 2015
5 Nëntor 2015	Publikimi i rezultateve të tremujorit të tretë të 2015

REZULTATET E KONSOLIDUARA TË CRÉDIT AGRICOLE S.A.

<i>(në milion euro)</i>	T3-14	Ndryshimi T3/T3*	9M-14	Ndryshimi 9M/9M*
Të Ardhurat	4,013	+4.0%	11,959	+2.1%
Shpenzimet Operative	(2,764)	+0.0%	(8,250)	(0.3%)
Fitimi operacional bruto	1,249	+13.9%	3,709	+8.0%
Kosto e riskut	(581)	(8.0%)	(1,705)	(16.2%)
Fitimi operativ	668	+43.4%	2,004	+43.3%
Përqindja e fitimit neto nga subjekte të kapitalit	296	(2.7%)	385	(59.2%)
Fitimi neto nga aktive të tjera	3	nm	11	(13.4%)
Ndryshimi në vlerën e emrit të mirë	-	nm	-	nm
Fitimi para tatimit	967	+25.8%	2,400	+2.0%
Tatimi	(94)	(21.0%)	(448)	+19.4%
Fitimi neto nga operacionet jo të vazhdueshme	-	nm	6	nm
Fitimi neto	873	+6.0%	1,958	(9.6%)
Interesat jo-kontrolluese	115	+21.2%	315	+15.3%
Fitimi neto i Grupit	758	+4.1%	1,643	(13.2%)

*Riparaqitur për subjektet e kapitalit të konsoliduara sipas metodës në vitin 2013 dhe riklasifikimit sipas IFRS5 të Crelan

Të ardhurat arrijnë në 4,013 milion euro në tremujorin e tretë të vitit 2014 dhe 11,959 milion euro në nëntëmujorin e parë. Këto shifra përfshijnë artikuj specifikë me një total prej +57 milion euro në tremujorin e tretë të vitit 2014 krahasuar me -156 milion euro në tremujorin e tretë të vitit 2013. Në të dyja këto vite, këto elementë ishin marzhi emetues i Crédit Agricole CIB dhe marzhi lidhur me kontratat e sigurimit për njësi të rezervuara në Qendrën e Korporatës, si dhe drejtimin e DVA dhe mbrojtjen e kredisë në Korporatë dhe në investimet bankare. Në tremujorin e tretë të 2013, ata përfshinë gjithashtu shitjen e Bankinter (143 milion euro të rezervuara në Qendrën e Korporatës). Duke përjashtuar ndikimet e kontabilitetit (drejtimi DVA dhe mbrojtja e kredisë), të ardhurat e linjave të biznesit ishin ulur me 0.9%, gjysma e kësaj rënieje vjen nga kursimet për blerje shtëpie sipas dispozitave të LCL si pasojë e normës së ulët të interesit.

Shpenzimet operative ishin 2,764 milion euro, të qëndrueshme krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Kursimet e kostos sipas programit MUST në vlerën prej 40 milion në tremujorin e tretë të 2014, duke sjellë një total prej 455 milion euro që nga fillimi i programit në 2012. Objektivi i përgjithshëm është 650 milion euro nga 2016. Këto kursime ndihmuan për të kompensuar shpenzimet e njohura në lidhje me planin e transformimit LCL (8 milion euro) dhe integrimin Amundi të subjekteve të reja në Shtetet e Bashkuara, Poloni dhe Amsterdam (7 milion euro). Në total, raporti kosto/fitim ishte 68.9% në tremujorin e tretë të 2014, një përmirësim vit pas viti prej 2.7 pikësh.

Kostoja e riskut mbeti e moderuar në 581 milion euro, nën 8.0% në tremujorin e tretë të 2013. Kostoja e riskut të linjave të biznesit ishte ulur ndjeshëm me 19.0% gjatë të njëjtës periudhë, kryesisht për shkak të përmirësimit të vazhdueshëm në tregun bankar francez me pakicë dhe veprimtarinë financiare. Dispozitat e përgjithshme ligjore janë lënë mënjanë në qendrën e korporatës në tremujorin e tretë të 2014.

Kostoja e riskut ishte 50 pikë bazë nga papagimet në baza vjetore, krahasuar me 59 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013 dhe 52 pikë bazë në tremujorin e dytë të 2014. Në tregun bankar me pakicë, kostoja e riskut të LCL arriti të ulët në 17 pikë bazë (kundrejt 25 pikëve bazë në tremujorin e tretë të 2013); Kostoja e riskut e Cariparma mbeti e lartë në 109 milion euro, duke u rritur vit pas viti me 18.2% në tremujorin e tretë të 2014. Financa e konsumatorit uli koston e

riskut, kryesisht në filialet Italiane Agos Ducato, ku kostoja e riskut për tremujorin e tretë të 2014 një total prej 125 milion euro, ulet 38.6% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Përtej degëve të financimit të konsumatorëve, kostoja vjetore e riskut qëndroi në 252 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2014, kundrejt 316 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013. Në investimin dhe korporatën bankare, kostoja e riskut mbetet e ulët. Në veprimtaritë financiare, pasqyrohet 30 pikë baze papagimi.

Kreditë me problem e (duke përfshirë qiratë financiare, transaksionet e brendshme të Crédit Agricole dhe interesat e përlogaritura) janë 16.0 miliard euro, duke pasqyruar 3.9% të kredive të papaguara bruto ndërbankare dhe konsumatore, të qëndrueshme krahasuar me tremujorin e tretë të 2013¹. Raporti i kredive të mbuluara, me problem, nga rezerva specifike ishte 55.3% kundrejt 57.9% më 30 Shtator 2013¹. Duke përfshirë rezervat kolektive, raporti i kredive me probleme të mbuluara ishte 72.2% në tremujorin e tretë të 2014.

Fitimi neto nga subjektet e kapitalit ishte 296 milion euro, duke përfshirë një kontribut prej 212 milion euro nga Bankat Rajonale.

Fitimi para tatimit ishte 967 milion euro krahasuar me 771 milion euro në tremujorin e tretë të 2013².

Të ardhurat neto nga operacionet jo të vazhdueshme ose të mbajtura për shitje përfshinin ndikimin e disponimit të ndërmjetësit CLSA dhe disponimin e planifikuar të Newedge për 161 milion euro.

Ndër të tjera, Fitimi neto i Grupit Crédit Agricole SH.A arriti 758 milion euro për tremujorin e tretë të 2014. Artikujt specifikë të kontabilitetit të rishqyrtuara (drejtimi DVA dhe mbrojtja e kredisë) dhe ndikimi i ndërmjetësve në tremujorin e tretë të 2013, pjesa e fitimit neto të grupit të linjave të biznesit është rritur me 12.3%.

Aftësia Paguese

Raporti CET1 i ngarkuar plotësisht ishte 10.1% në fund të muajit shtator 2014 krahasuar me 9.9% në fund të qershorit 2014. Përmirësimi me 20 pikë bazë gjatë tremujorit ishte shkak i rritjes me 0.2 miliard euro në raportin e kapitalit CET1 shoqëruar me një ulje prej 3.7 miliard euro të aktiveve të ponderuara me risk në 297.6 miliard euro në fund të Shtatorit.

Në tremujorin e tretë të 2014, rritja e kapitalit CET1 erdhi kryesisht nga ndikimi i fitimeve të pashpërndara për 0.4 miliard euro (+13 pikë bazë) dhe një rritje të fitimeve të parealizuara për 0.2 miliard euro (+6 pikë bazë) për shkak të normës së ulët të interesit. Dispozita e vlerësimit të matur ishte rritur me 0.3 miliard euro (-10 pikë bazë) në 1 miliard euro gjatë tremujorit. Ulja e aktiveve të ponderuara me risk erdhi kryesisht nga ulja e kredisë dhe riskut të tregut në korporatë dhe investimet bankare. Raporti total i Crédit Agricole SH.A ishte 19.2% në fund të Shtatorit 2014, një përmirësim me 360 pikë bazë që nga fillimi i vitit.

Crédit Agricole SH.A kishte lëshuar një AT1 prej 1.25 miliard dollarë USD (rreth 1 miliard euro) gjatë tremujorit, duke sjellë kështu një total të kapitalit të lëshuar AT1 që prej fillimit të vitit deri në 3.8 miliard euro³.

¹ Pro forma për riklasifikimin IFRS5 : Subjektet Crelan, Newedge, CA Bulgaria and CACF Nordic , CAL Hellas dhe CA Immobilier më 30/06/2013; Crelan dhe CAL Hellas më 31/12/2013

² Llogaritë e subjekteve të konsoliduara dhe pasqyruara nën metodën proporcionale të vitit 2013 dhe riklasifikimi sipas IFRS5 të Crelan

³ Tarifa neto e sigurimit

LIKUIDITETI

Bilanci monetar i Grupit Crédit Agricole në total ishte 1,034 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014 krahasuar me 1,039 miliard euro në fund të Muajit Dhjetor 2013 dhe 1,049 miliard në fund të Shtatorit 2013.

Teprica e burimeve të financimit afatgjatë mbi aplikimet afatgjata të fondeve ishte 89 miliard euro në fund të Shtatorit 2014, deri në 18 miliard euro që prej fundit të muajit Dhjetor 2013, dhe duke rezultuar në një raport mbulimi prej 111%.

Rezervat e likuiditetit pas rënies në vlerën 248 miliard euro në fund të shtatorit 2014, duke mbuluar 173% të borxhit bruto afatshkurtër kundrejt 168% në tremujorin e tretë të 2013 dhe në fund të Dhjetorit 2013. Raporti LCR i Grupit ishte më shumë se 110% në fund të shtatorit 2014.

Në nëntëmujorin e parë të 2014, emetuesit kryesorë brenda Grupit Crédit Agricole emetuan 25.8 miliard euro borxh në treg dhe në rrjetin e degëve. Crédit Agricole SH.A ka lëshuar gjithashtu tre Tier 1 shtesë të barabartë me 3.9 miliard euro.

REZULTATET SIPAS LINJËS SË BIZNESIT

1. TREGU BANKAR FRANCEZ ME PAKICË

1.1. BANKAT RAJONALE TË CRÉDIT AGRICOLE

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Të ardhurat neto të llogaritura sipas metodës së kapitalit neto (në ~ 25%)	216	(7.1%)	677	(0.6%)
Ndryshimi në pjesën e rezervave	(4)	nm	148	(2.9%)
Pjesa e Fitimit Neto të enteve me kapital të kontabilizuar	212	(10.0%)	825	(1.1%)

Bankat Rajonale vazhduan të zhvillonin biznesin e tyre në një treg vazhdimisht të ngadaltë, në një mjedis të zyrtë ekonomik me klimë rregullatore të pafavorshme.

Aktivitetet e konsumatorëve u rritën me 2.7% vit pas viti për të arritur 596 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014, duke përfshirë 350 miliard euro në depozitat e bilancit, e cila u rrit me 3.0% vit pas viti. Krahasuar me fundin e muajit Shtator 2013, rritja në depozitat e bilancit u arrit nga llogaritë e kursimit (+3.3%), llogaritë rrjedhëse (+4.2%) dhe plani i kursimeve të blerjeve të shtëpive, i cili u rrit me 2.2% vit pas viti, nxitur nga rritja me 4.3% të sigurimit të jetës.

Kreditë e papaguara ishin në vlerën e 400 miliard euro më 30 Shtator 2014, deri 0.7% vit pas viti, duke reflektuar tendencën e përzier të varur nga tregu. Kreditë për shtëpi u rritën me 2.3% vit pas viti, ndërkohë kredia e konsumatorit dhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe bizneset e vogla ranë me 3.6% dhe 3.1% respektivisht gjatë 12 muajve.

Raporti kredi/depozita⁴ qëndroi 115% në fund të Shtatorit 2014, një përmirësim me pothuajse 1 përqind krahasuar me fundin e muajit 2013.

⁴ Metodologjia e rishikuar nga Mars 2014; Dhjetor 2013 pro farma; duke përfshirë financimin EIB dhe CDC dhe obligacionet Casa të kontratave të lidhura për njësi të klasifikuara në fondet e lidhura të klientit; dhe kreditë e klientit neto të rezervave të vecanta

Të ardhurat e Bankave Rajonale (të ripasqyruara për transaksionet brenda grupit) arritën në 23.3 miliard euro në tremujorin e tretë të 2014, me një rënie prej 4.5% vit pas viti krahasuar me një bazë të lartë në tremujorin e tretë të 2013, e cila duke përfutur nga ndikimi pozitiv i riblerjeve të kredive dhe ripagesat e hershme të shoqëruara me një kosto më të ulët të depozitave dhe financimit. Tremujori i tretë i 2014 u ndikua gjithashtu nga norma e ulët e interesit dhe kurba e rrafshët, e cila krijon presion në marzhin e ndërmjetësimit. Për më tepër, tarifa dhe fitimi I komisionit ishin ndikuar nga mjedisi rregullator i papërshtatshëm, duke u ulur me 3.4% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2013 për shkak të menaxhimit të llogarisë të komisionit dhe instrumentat e pagesës, të cilat ishin ulur me 7.3%. Komisionet e Sigurimit ishin ulur lehtë në tremujorin e tretë të 2014 por rritur me 0.3% vit pas viti në nëntëmujorin e parë të 2014.

Shpenzimet operative ishin ulur me 0.5% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014.

Në tremujorin e tretë të 2014, kostoja e riskut ra në mënyrë të konsiderueshme në 10 pikë bazë të kredive të papaguara kundrejt 19 pikë bazë në fund të shtatorit 2013 dhe 22 pikë bazë në tremujorin e dytë të 2014. Kostoja e riskut me vlerë në 94 milion euro për periudhën, një ulje prej 49.7% krahasuar me 105.7% në fund të shtatorit 2013. Raporti i kredive me probleme ishte i qëndrueshëm në 2.5% të totalit të kredive të papaguara.

Fitimi operativ arriti në 1,328 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me 1,382 në tremujorin e tretë të 2013.

Ndryshimi në pjesën e fitimit neto të Bankave Rajonale ishte në -4milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me kontributin pozitiv prej 3 milion euro në tremujorin e tretë të 2013. Për nëntë muajt e parë të vitit, ishte 148 milion euro, një rënie vit pas vitit prej 2.9%. Kontributi i Bankave Rajonale në fitimin neto të Grupit Crédit Agricole S.H.A ishte 212 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me 235 milion euro në tremujorin e tretë të 2013. Për nëntë muajt e parë të vitit, ai ishte 825 milion euro, një rënie prej 1.1% vit pas viti.

1.2. LCL

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Te ardhurat	935	+1.8%	3,811	(3.0%)
Shpenzime operative	(645)	+0.8%	(2,514)	+1.2%
Fitimi operacional bruto	290	+3.9%	1,297	(5.3%)
Kosto e riskut	(86)	+11.3%	(304)	(2.4%)
Fitimi operativ	204	+1.1%	993	(6.1%)
Fitimi neto nga aktive te tjera	-	nm	5	nm
Fitimi para tatimit	204	+0.1%	998	(5.7%)
Tatimi	(92)	+22.6%	(368)	+1.8%
Fitimi neto	112	(12.8%)	630	(9.7%)
Interesat jo-kontrolluese	5	(12.3%)	31	(9.5%)
Fitimi neto i Grupit	107	(12.8%)	599	(9.7%)

LCL vazhdon të mbështesë individët në financimin e projekteve të tyre. Tremujori i tretë I 2014 kishte një vazhdim të tendencës të vërejtur në tremujoret e mëparshme, me një kombinim të depozitave më të larta dhe prodhimin e matur në kreditim.

Kreditë e papaguara ishin në vlerën e 90.4 miliard euro më 30 Shtator 2014, me një rritje prej 1.3% krahasuar me vitin e mëparshëm. Rritja kishte ardhur nga kreditë për shtëpi, të cilat u rritën me 3.2% vit pas viti në 57.8 miliard euro.

Drejtuar nga momenti i mirë dhe i fuqishëm biznesit, aktivet e klientit u rritën me 2.6% vit pas viti në vlerën e 167.3 miliard euro. Asetet e klientit jashtë bilancit u rritën me 2.3% nxitur nga rritja e llogarive rrjedhëse (+8.1%).

Raporti i kredi-depozita ishte 110% në fund të muajit Shtator 2014, i qëndrueshëm krahasuar me fundin e muajit Qershor 2014.

Të ardhurat u ulën me 2.2% vit pas viti në tremujorin e tretë në vlerën prej 899 milion euro, pas eliminimit të ndikimit nga parashikimet për planet e kursimeve për blerje shtëpie. Kjo shpjegohet me një rënie prej 4.4% vit pas vitit të marzhit neto të interesit (duke përfshirë parashikimet për planet e kursimeve për blerjen e shtëpive), kryesisht për shkak të ndikimit të riblerjes së kredive dhe ripagimet e hershme, të cilat arritën kulmin në tremujorin e dytë dhe të tretë të 2013. Fitimi i Komisioneve dhe tarifave u rrit me 1.2% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014, nxitur kryesisht nga komisionet e sigurimit (+2.8% vit pas viti), menaxhimi i llogarisë dhe instrumentat e pagesës (+2.1% vit pas viti).

Shpenzimet operative mbeten të mirëadministruara. Ato u rritën me 1.4% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014 para shpenzimeve të lidhura me Planet afatmesme. Shpenzimet e lidhura me planin e biznesit arritën në vlerën e 8 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, pas 11 milion në gjashtëmujorin e parë. Raporti kosto/fitim ishte 69.1% në tremujorin e tretë të 2014.

Kostoja e riskut u ul me 31.9% vit pas viti, duke reflektuar një përmirësim të riskut të të gjitha tregjeve. Raporti i kredive me probleme arriti në 2.4%, i qëndrueshëm në krahasim me fundin e muajit Qershor 2014. Raporti i kredive me probleme të mbuluara (duke përfshirë edhe rezervat kolektive) ishte 73.6% krahasuar me 74.0% të fundit të muajit Qershor 2014. Kostoja e riskut arriti në nivelin e ulët të 17 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2014, kundrejt 25 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013.

Fitimi neto i Grupit ishte 136 milion euro, me një rënie prej 14.6% (ose 6.1% pas eliminimit të ndikimit të parashikimeve për planet e kursimeve për blerje shtëpie) krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Fitimi neto i Grupit ishte në vlerën e 443 milion euro për nëntëmujorin e parë të vitit.

2. TREGU BANKAR NDËRKOMBËTAR ME PAKICË

Fitimi neto i Grupit për linjën e biznesit ishte 47 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me 17 milion euro në tremujorin e tretë të 2013. Për nëntëmujorin e parë të 2014, fitimit neto i Grupit ishte -537 milion euro kundrejt 70 milion euro për nëntëmujorin e parë të 2013. Në tremujorin e dytë të 2014, ai përfshinte një ndikim negativ prej -708 milion euro në pjesën e fitimit neto të enteve me kapital të kontabilizuar lidhur me zgjidhjen e BES.

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Te ardhurat	630	+4.3%	1,990	+10.1%
Shpenzime operative	(364)	(0.5%)	(1,094)	(2.8%)
Fitimi operacional bruto	266	+11.7%	896	+31.4%
Kosto e riskut	(156)	+30.4%	(556)	+27.8%
Ftimiti operativ	110	(7.1%)	340	+37.5%
Kapitali i Filialeve		nm	(719)	x9.9
Fitimi neto nga aktive te tjera		nm	(2)	nm
Ndryshimi ne vleren e emrit te mire		nm	-	nm
Fitimi para tatimit	110	+25.9%	(381)	nm
Tatimi	(37)	(26.9%)	(107)	+34.4%
Te ardhura nga operacionet jo te vazhdueshme		nm	14	+8.6%
Fitimi neto	73	+92.2%	(474)	nm
Interesat jo kontrolluese	26	+29.3%	63	+33.3%
Fitimi neto i Grupit	47	x2.6	(537)	nm

Kontributi Cariparma për rezultatet e Crédit Agricole

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14 ⁵	Change 9M ⁵ /9M ⁶
Të ardhurat	410	+3.7%	1,219	+3.7%
Shpenzime operative	(230)	+2.3%	(691)	(2.8%)
Kosto e riskut	(109)	+18.2%	(319)	+8.0%
Të ardhurat neto	43	+21.0%	133	+15.0%
Pjesa e të Ardhurave Neto të Grupit	32	+26.1%	96	+14.6%

⁵ Duke përfshirë artikujt e njohur nga Cariparma në pasqyrat eksponuar lokale më 31/12/13, pas mbylljes të pasqyrave financiare të Crédit Agricole S.H.A, psh +80m euro të ardhura, o/w +92m euro për vlerësimin e aksioneve të Bankës së Italisë dhe -109m euro në koston e riskut dhe pasojat e tatimit lidhur me këto rideklarime.

⁶ Pas rklasifikimit në dispozitat shtesë të Q4-12 kërkuar nga Banka e Italisë regjistruar në Qendrën e Korporatës në Q3-12 dhe në kontributin e Cariparma në Q1-13 (39m euro)

Në Itali, Cariparma vazhdoi të transformojë rrjetin e saj dhe rezultatoi me rritje krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Kreditë e papaguara ishin 33.3 miliard euro më 30 Shtator 2014, një rritje vit pas viti prej 0.8%, duke përfshirë 5.1% rritjen e kredive për shtëpi. Totali i depozitave brenda bilancit qëndroi në vlerën e 35.3 miliard euro. Raporti i kredive (rezervat e vecanta neto) dhe depozitave ishte 89%. Aktivët e klientit jashtë bilancit të Cariparma qëndruan në vlerën e 56.1 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014 krahasuar me 51.4 miliard euro në fund të muajit Shtator 2013. Sigurimi i jetës dhe fondeve të përbashkëta mbeti e fuqishme, me rritje prej 18.2% krahasuar me fundin e muajit shtator 2013.

Të ardhurat u rritën në mënyrë të vazhdueshme që nga fillimi i vitit 2013, duke u rritur me 3.7% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014, kryesisht për shkak të përmirësimit të marxhinës dhe rritja e fitimit të komisioneve dhe tarifës. Marxhina e rritjes u nxit nga kostoja mesatare e ulët e depozitave dhe investimeve të likuiditetit të tepërt me filialet e tjera Italiane të Grupit, ndërkohe rritja e fitimit të komisioneve dhe tarifës u nxit nga rritja e depozitave jashtë bilancit.

Shpenzimet operative mbetën nën kontroll duke u rritur me 2.3% vit pas viti në tremujorin e tretë, por duke u ulur me 2.8% vit pas viti në nëntëmujorin e parë të 2014.

Raporti kosto/fitim vazhdoi të bjerë. Ai qëndroi në 56.1% për tremujorin e tretë, një rënie prej 0.8 pikë përkatësisht me tremujorin e tretë të 2013, dhe 56.7% për nëntëmujorin e parë të vitit, një rënie prej 3.8 pikë respektivisht me të njëjtën periudhë të 2013.

Kostoja e riskut u rrit me 18.2% në vlerën e 109 milion euro krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Raporti i kredive me probleme dhe totali i atyre të papaguara ishte 12.6%, me një raport të mbuluar prej 44.2% (duke përfshirë rezerva kolektive).

Të ardhurat neto të grupit të Cariparma ishin 32 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, krahasuar me 25 milion euro në tremujorin e tretë të 2013.

Subjektet e tjera ndërkombëtare të Grupit kishin një suficit të depozitave mbi kreditë më 30 Shtator 2014, me 10.7 miliard euro të depozitave brenda bilancit dhe 10.1 miliard euro për kreditë bruto. Subjektet Europiane të Grupit duke përfshirë Cariparma kanë kontribuar 20% të linjës së biznesit të pjesës së të ardhurave neto të grupit, ndërkohë subjektet e Grupit në Afrikë dhe Lindjen e Mesme kanë kontribuar me 15%. Në total, pjesa e të ardhurave neto të Grupit të Cariparma nga kontributet e tyre ishte 15 milion euro në tremujorin e tretë të 2014.

3. MENAXHIMI I KURSIMEVE DHE SIGURIMI

Kjo linjë biznesi përfshin menaxhimin e aktiveve, të sigurimit, tregun bankar privat dhe shërbimin e aktiveve.

Aktivët nën menaxhim kishin një vlerë prej 1,229 miliard euro më 30 Shtator 2014, një rritje me 85 miliard euro që prej 31 Dhjetorit 2013, nxitur nga një moment i qëndrueshëm i biznesit dhe efekt pozitiv të tregut. Duke përfshirë tregun dhe efektin në valutë të më shumë se 55 miliard euro, rritja ishte më shumë se 29 miliard euro, duke përfshirë më shumë se 22 miliard euro në manxahimin e aktiveve dhe pothuajse 6 miliard euro në sigurimin e kursimeve/pensioneve.

Fitimi neto për pjesë e Grupit ishte 398 milion euro për tremujorin e tretë të 2014, deri në 4.2% vit pas viti. Për nëntë mujorin e parë të vitit, ai ishte 1.159 milion euro, nga të cilat 67% erdhën nga sigurimi i kursimeve/pensioneve dhe 24% nga menaxhimi i aktiveve.

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
------------------	-------	--------------------	-------	--------------------

Të ardhurat	1,242	+1.1%	5,130	+0.4 %
Shpenzimet operative	(642)	+5.2%	(1,913)	+3.6%
Fitimi operacional bruto	600	(2.9%)	1,883	(2.6%)
Kosto e riskut	(2)	nm	(47)	nm
Fitimi operativ	598	(3.7%)	1,836	(5.0%)
Kapitali i filialeve	4	x5.6	12	+8.0%
Fitimi neto nga aktive të tjera	1	nm	7	nm
Fitimi para tatimit	603	(3.1%)	1,855	(4.6%)
Tatimi	(167)	(18.3%)	(589)	(6.6%)
Fitimi neto	436	+4.3%	1,266	(3.6%)
Interesat jo-kontrolluese	38	+5.5%	107	(8.9%)
Fitimi neto i Grupit	398	+4.2%	1,159	(3.1%)

Në menaxhimin e aktiveve, aktivet Amundi nën menaxhim ishin në vlerën 844 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014, me një rritje prej 8.6% që prej fundit të Dhjetorit 2013. Fluksi neto arrin në totalin e 22.3 miliard euro për nëntë muajt e parë të vitit duke përfshirë 9.6 miliard euro në tremujorin e tretë të 2014. Aktivet afatgjata ishin në vlerën e 25.8 miliard euro (duke përfshirë 8.1 miliard euro në tremujorin e tretë të 2014) nxitur kryesisht nga obligacionet, ndjekësit e indeksit dhe ETF. Amundi regjistroi një performancë të fuqishme në rrjetin e huaj, fillimisht në Europë dhe Azi, me flukse prej 14.4 miliard euro. Flukset nxiten nga segmentet e klientit përveç rrjeteve të degës Franceze, kontribuesit kryesor janë institucionet dhe korporatat e mëdha (+13.5 miliard euro), distributorët palë e tretë (+7.3 miliard euro) dhe rrjetet e degëve të huaja (+3.3 miliard euro). Në rrjetet e degës franceze, flukset dalëse neto vazhduan të ngadalësohen, duke arritur në -1.8 miliard euro në nëntëmujorin e parë të vitit. Duke përjashtuar fondet e tregut monetar, flukset dalëse neto përmbanin vetëm -0.2 miliard euro gjatë të njëjtës periudhë, me 0.1 miliard euro të flukseve hyrëse neto pozitive në tremujorin e tretë të 2014. Efekti i tregut dhe i valutës ishte 44.5 miliard euro gjatë periudhës.

Nxitur nga momenti i mirë i biznesit, tendenca pozitive në tregun financiar dhe një nivel i lartë veçanërisht i tarifave të performancës në tremujorin e tretë, të ardhurat u rritën me 20.9% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014, në 420 milion euro. Kostot operative mbetën nën kontroll, duke u rritur me vetëm 3.6% gjatë të njëjtës periudhë përjashtuar subjektet e reja në Shtetet e Bashkuara (Smith Breeden), Poloni dhe Hollandë. Raporti kosto/fitim u përmirësua me 6.6 pikë vit pas viti në 49.7% në tremujorin e tretë. Ndër të tjera, pjesa e fitimit neto të grupit Amundi arriti në 109 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 dhe 276 milion euro për nëntëmujorin e parë të vitit.

Amundi vazhdon të ndjekë strategjitë ndërkombëtare të zhvillimit, duke njoftuar në Tetor blerjen e aktiveve Austriake (subjekt i miratimit nga autoritetet përkatëse) të Bawag Invest nga Banka Bawag PSK, dhe një shpërndarje e partneritetit të njëkohshëm me Bankën, e cila ka 1.6 milion klientë individualë. Për më tepër, Amundi hapi disa subjekte në Tajlandë dhe Zyrë gjatë tremujorit të tretë të 2014.

Në shërbimin e aktiveve, CACEIS pësoi rritje të mëtejshme në aktivet e menaxhuara gjatë tremujorit. Aktivet nën kujdestari u rritën me 6.3% gjatë një viti në vlerën e 2,377 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014, duke përfshirë një efekt pozitiv të tregut. Për më tepër, fondet nën administrim u rritën me 5.1% gjatë kësaj periudhe në vlerën e 1,363 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014, duke u nxitur kështu nga klientët të rinj, të fituar gjatë tremujorit dhe rinovimit pesë vjeçar të mandatit të Sigurimit CNP gjatë tremujorit të mëparshëm.

Rezultatet CACEIS kanë qënë të qëndrueshme që prej fillimit të vitit, të ndikuara nga tkurrje e marxhinës së interesit krahasuar me 2013 të shkaktuar nga një rënie e vazhdueshme në likuiditet dhe shoqërimin me një rritje paralele në rendimentin e ulët të letrave me vlerë. Pjesa e Fitimit Neto të Grupit ishte 19 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, të pandryshuar nga tremujori i parë dhe i dytë dhe rënien 43.0% vit pas viti.

Bankingu Privat pati fitime neto të kënaqshme në tremujorin e 2014 duke u nxitur nga momenti i mirë i biznesit. Aktivet nën menaxhim u rritën me 5.7% që prej fundit të Dhjetorit 2013, duke arritur pothuajse në vlerën e 140 miliard euro në fund të Shtatorit, duke përfshirë një efekt pozitiv të tregut.

Në Francë, aktivet nën menxhim u rritën me 3.1% krahasuar me fundin e muajit Shtator 2013, në vlerën 63.6 miliard euro. Jashtë vendit, ku bankingu privat hapi një degë në Itali gjatë tremujorit të tretë, rritja ishte +6.7% dhe aktivet arritën 76.1 miliard euro.

Pjesa e Fitimit Neto të Grupit ishte 20 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, me një rënie prej 16.1% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013.

Sigurimi i Crédit Agricole ka raportuar fitim prej 7.2 miliard euro në tremujorin e tretë të 2014, një rritje prej 18.6% vit pas viti. Për nëntë muajt e parë të vitit, të ardhurat ishin në një total prej 22.7 miliard euro, një rritje vit pas viti prej 12.4%.

(në milion euro)	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Të ardhurat	476	(8.3%)	1,580	+0.2 %
Shpenzimet operative	(153)	+8.5%	(456)	+6.4%
Fitimi operacional bruto	600	(14.5%)	1,124	(2.1%)
Kosto e riskut	(1)	nm	(1)	nm
Fitimi neto nga aktive të tjera	-	nm	-	nm
Tatimi	(72)	(43.5%)	(343)	(10.1%)
Fitimi neto	250	(0.4%)	780	+1.7%
Fitimi neto i Grupit	250	(0.6%)	778	+1.6%

Kursimet/pensionet gëzojnë një rritje, me fitim premium prej 5.9 miliard euro në tremujorin e tretë të 2014, një rritje prej 22.0% vit pas viti. Në nëntë muajorin e parë të vitit, të ardhurat arritën në pothuajse 18.0 miliard euro kundrejt 15.7 miliard euro në 2013, një rritje prej 14.3% vit pas viti.

Në Francë, fitimi premium u rrit me 6.5% vit pas viti në tremujorin e tretë, edhe pse tremujori i tretë i 2013 ishte në një bazë të lartë për krahasim. Ndërkombëtarisht, fitimi premium u rrit me 77.1% me një kontribut të madh veçanërisht nga Italia. CA Vita pati një rritje prej 109.1% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014 dhe 78.3% për nëntë muajt e parë të vitit. Kjo krahasuar me 33% rritje vit pas viti për tregun Italian si e tërë gjatë tetë muajve të parë të 2014 (burimi IAMA).

Flukset neto në kursime/pensione dhe vdekje/paftësi ishin 6.7 miliard euro për nëntë muajt e parë duke përjashtuar efektin e tregut, përfshirë 3.8 miliard euro në Francë.

Në **kursime/pensione**, aktivet nën menaxhim u rritën me 5.5% vit pas viti duke arritur në 245.1 miliard në fund të Shtatorit 2014. Fondet në euro ishin në vlerën e 198.8 miliard euro, me një rritje prej 4.6% vit pas viti, ndërkohë fondet për njësi të lidhura u rritën me 9.4% vit pas viti në vlerën e 2.8 miliard euro, duke paraqitur në total 18.9% (+0.7 pikë gjatë vitit).

Në rastet e **vdekjeve & paftësi/shëndeti/kreditor**, fitimi premium u rrit me 3.7% në 844 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, kundrejt 814 milion euro në 2013. Në nëntë muajt e parë të vitit, fitimet premium u rritën me 4.4% vit pas viti në vlerën 2.8 miliard euro. Vdekja & paftësia/shëndeti vazhduan të rriten me 5.3% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014, ndërkohë sigurimi i kreditorit pati një rritje me 2.3% nxitur nga një performancë e mirë në sigurimin e kredive për shtëpi.

Në sigurimin e pronës & fatkeqësive, rritja mbeti e lartë, me fitim premium në vlerën e 485 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, një rritje prej 8.3% vit pas viti, dhe më shumë se 1.9 miliard euro në nëntë muajt e parë të vitit, një rritje prej 7.4%. Raporti i kombinuar ⁷(risigurimi neto) mbeti i mirëkontrolluar në 95.6% për nëntë muajt e parë të 2014, pavarësisht ngjarjeve të përsëritura të lidhura me kohën që nga fillimi i vitit.

⁷ Raporti i (ankesave+shpenzimet operative) fitimit neto. Qëllimi Pacifica

Pjesa e Fitimit Neto të Grupit për linjën e biznesit Sigurime ishte 250 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, e qëndrueshme në krahasim me të njëjtën periudhë për vitin e mëparshëm, pavarësisht rënies të të ardhurave sipas fitimeve të realizuara në portofol, taksa lidhur me xhiron dhe shpenzimi në zhvillimin e sigurimit të biznesit të Grupit. Gjatë nëntë muajve të parë, pjesa e Fitimit Neto të Grupit u rrit me 1.6% në vlerën e 778 milion euro.

4. SHËRBIME FINANCIARE TË SPECIALIZUARA

(NË MILIONA EURO)	T3-14	Ndryshimi T3/T3*	9M-14	Ndryshimi 9M/9M*
Të ardhurat	648	(11.8%)	2,012	(8.1%)
Shpenzimet operative	(333)	(6.6%)	(997)	(5.1%)
Fitimi operacional bruto	315	(16.7%)	1,015	(10.9%)
Kosto e riskut	(252)	(24.2%)	(795)	(28.5%)
Fitimi operativ	63	+38.4%	220	x7.9
Fitimi neto për pjesë nga subjektet e kapitalit	39	+28.8%	107	+16.2%
Fitimi para tatimit	102	+35.3%	327	x2.7
Tatimi	(10)	(65.1%)	(58)	+1.2%
Të ardhurat neto nga operacionet jo të vazhdueshme	-	(98.6%)	(9)	nm
Fitimi neto	92	+72.5%	260	x3.2
Interesat jo-kontrolluese	17	nm	27	nm
Fitimi neto i Grupit *	75	+17.5%	233	+78.6%

*Riparaqitur për riklasifikim nën IFRS5 të subjekteve Nordike CACF dhe aplikimin e IFRS 11 të shoqërive të përbashkëta dhe partneriteteve të financimit të makinës.

Shërbimet financiare të specializuara njoftuan pjesën e fitimit neto të Grupit prej 75 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 kundrejt 63 milion euro të vitit të kaluar, një rritje prej 17.5%. Në linjë me rënien e papagimit krahasuar në vitin e kaluar, të ardhurat për linjën e biznesit u ulën me 11.8% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013, në vlerën e 648 milion euro. Shpenzimet operative u ulën me 6.6% në tremujorin e tretë të 2013. Kostoja e riskut vazhdoi të bie në 24.2% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013.

Në financat e klientit, libri i kredisë së menaxhuar mbeti virtualisht e pandryshuar në 68.7 miliard euro krahasuar me 69 miliard euro në fund të muajit Qershor 2014. Ajo ka qënë e qëndrueshme që prej fillimit të vitit, duke përjashtuar daljen efektive të 400 milion euro lidhur me subjektet Nordike të shitura në tremujorin e parë. Ndarja gjeografike është pak a shumë e njëjtë si në tremujorin e mëparshëm, me 37.3% të papaguara në Francë, 33.5% në Itali dhe 29.2% në vende të tjera. Papagesat e konsoliduara ishin 34.1 miliard euro, nën 10.4% vit pas viti për shkak të depozitimeve kryesisht gjatë kësaj periudhe. Partneritetet e financimit të makinës u rritën me 4.8% vit pas viti në 18.1 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014, ndërsa regjistri i kredive të Grupit Crédit Agricole mbeti pak a shumë i qëndrueshëm në vlerën 12.2 miliard euro.

Ndërkohë, CACF vazhdoi të forcojë raportin e tij të vetfinancimit, i cili është rritur me 9 pikë që nga fundi i muajit shtator 2013 për të arritur 58.5%. Kjo performancë e mirë erdhi nga suksesi i konfirmuar i depozitave të biznesit të CACF në Gjermani (nën pasaportë Europiane), me flukset hyrëse deri në 31.2% nga tremujori në tremujor në më shumë se 690 milion euro në fund të Shtatorit 2014, shoqëruar me sigurimin FGAC në vlerën e 750 milion euro të EMTN gjatë tremujorit të tretë.

CACF raportoi të ardhura në vlerën e 520 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, ulur me 3.1% tremujor pas tremujori. Vit pas viti ato u ulën me 14.0% për shkak të rënies së kredive të papaguar gjatë vitit të parë dhe rritjen e kostove të fondeve. Shpenzimet operative u ulën me 7.7% vit pas viti, duke reflektuar planet operationale eficente të shoqëruara me mbledhjen e masave për optimizimin e kostos. Kostoja e riskut në financat e klientit ishte 230 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, me një rënie prej 26.0% vit pas viti, duke reflektuar një ulje 38.6% në Agos Ducato, me subjektet e grupit tjetër CACF duke mbetur pak a shumë të qëndrueshëm (-1.8%). Kostoja e riskut u paraqit 252 pikë bazë, një përmirësim gjatë tremujorëve me 4 pikë bazë por një përmirësim i ndjeshëm gjatë viteve prej 64 pikë bazë. Kostoja e riskut të Agos-Ducato ishte 125 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 duke kontribuar me 64 pikë bazë në koston e riskut në vonesat e financimit të klientit në total (252 pikë bazë). Raporti i kredive me probleme të Agos-Ducato ishte 13.6% krahasuar me 12.6% të tremujorit të kaluar, dhe raporti i mbulimit të tij ngeli shumë i lartë në 98.7% duke përfshirë rezervat kolektive. Si rezultat i këtij përmirësimi të vazhdueshëm në riskun në Agos-Ducato, filiali e kishte të pamundur të mbantë kapacitetin e fitimeve.

Kontributi nga subjektet e kapitalit u rrit ndjeshëm me 28.8% në vlerën e 39 milion euro në tremujorin e tretë, duke reflektuar një performancë të mirë nga partneritetet e financimit të makinës.

Fitimi neto për pjesë e Grupit CACF në total ishte 53 milion euro, një rritje prej 9.8% vit pas viti.

Në Qirane Financiare dhe Faktoringun tendenca e vonesave ndryshon nga biznesi dhe rajoni gjeografik. Rënia e qirasë financiare vazhdoi në Francë (-3.6% krahasuar me fundin e Muajit Shtator 2013), duke rezultuar në një rënie prej 2.1% vit pas viti në pagesat totale prej 15.7 miliard euro. Në anën tjetër, ndërkombëtarisht vonesat e huasë financiare u rritën me 2.3% gjatë të njëjtës periudhë në 4.0 miliard euro dhe arkëtimet e faktorizuara u rritën me 8.0% në 15.1 milion euro në fund të muajit shtator, duke përfshirë një rritje 4.7% në Francë në vlerën 9.5 miliard euro.

Të ardhurat CAL&F arritën në shumën e 128 milion euro në tremujorin e tretë, duke u ulur lehtë me 1.2% vit pas viti si pasojë e rënies së financimit të huasë të papaguar në Francë. Shpenzimet Operative u ulën në një normë më të lartë me 2.5% gjatë të njëjtës periudhë. Fitimi operacional bruto u rrit me 0.7% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014. Kostoja e riskut mbeti pak a shumë e qëndrueshme në vlerën e 22 milion euro. Pas pagesave tatimore prej 10 milion euro kundrejt 16 milion euro në tremujorin e tretë të 2013, pjesa e Fitimit Neto të Grupit të CAL&F ishte 22 milion euro në tremujorin e tretë, një rritje me 41% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013.

5. KORPORATA DHE INVESTIMET BANKARE

Korporata dhe investimet bankare arritën në pjesën e fitimit neto të grupit në vlerën 241 milion euro në tremujorin e tretë të 2014. Riparaqitur për mbrojtjet e kredisë (+13 milion euro në fitimin neto të Grupit) dhe ndikimin e drejtimit të DVA (-17 milion euro në fitimin neto të Grupit), pjesa e fitimit neto të grupit ishte 245 milion euro në tremujorin e tretë të 2014.

Aktivitetet e financimit kontribuan në vlerën 190 milion euro të riparaqitura në pjesën e fitimit neto të grupit * (krahasuar me 195 milion euro në tremujorin e tretë të 2013) ndërkohë kapitali i tregut dhe investimet bankare kontribuan në vlerën e 42 milion euro (krahasuar me -40 milion euro në tremujorin e tretë të 2013).

Rezultatet e operacioneve jo të vazhdueshme ishin 13 milion euro në tremujorin e 2014 krahasuar me -21 milion euro në tremujorin e tretë të 2013.

Korporata dhe investimet bankare (përfshirë operacionet e vazhdueshme)

(në milion euro)	T3-14	T3-14*	T3-13	T3-13*	Ndryshimi T3*T3*
Të ardhurat	941	949	850	897	+5.6%
<i>o/w aktivitetet e financimit</i>	550	530	511	511	+3.8%
<i>o/w tregu i kapitalit dhe investimet bankare</i>	362	390	327	374	+4.0%
<i>o/w aktivitetet jo të vazhdueshme</i>	29	29	12	12	x2.3
Shpenzimet operacionale	(578)	(578)	(568)	(568)	+1.6%
Fitimi operacional bruto	363	371	282	329	+12.6%
Kosto e riskut	(65)	(65)	(127)	(127)	(48.9%)
Fitimi operacional	298	306	155	202	+51.1%
Fitimi neto nga subjektet e kapitalit	50	50	35	35	+50.1%
Të ardhurat neto nga aktivet e tjera	3	3	(1)	(1)	nm
Fitimi para tatimit	351	359	189	236	+52.4%
Tatimi	(105)	(108)	(80)	(97)	+9.9%
Të ardhurat neto nga ndërprerja ose nga operacionet e mbajtura për shitje	-	-	164	-	nm
Fitimi Neto	246	251	273	139	+82.3%
Interesat jo-kontrolluese	5	6	7	5	+35.7%
Fitimi neto i Grupit	241	245	266	134	+83.9%

* Riparaqitur për mbrojtjet e kredisë, ndikimi i DVA dhe ndikimet lidhur me biznesin e komisionereve në 2013.

Figurat N.B 2013 janë riparaqitur UBAF aktuale në përputhje me aplikimin e ri të IFRS 11

Të ardhurat nga **aktivitetet e financimit** arritën në vlerën e 530 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, duke përfshirë ndikimin e mbrojtjes së kredisë, një rritje vit pas viti me 3.8%. Të ardhurat nga banking tregtar ishin 235 milion euro, një rritje me 2.2% vit pas viti për shkak të rritjes të normës së interest dhe një nivel i mirë i aktivitetit, veçanërisht në biznesin financiar tregtar. Financa e strukturuar pati një performancë të mirë me të ardhura deri në 5.0% vit pas viti në vlerën e 295 milion euro, nxitur nga blerja e financave dhe transportit ajror dhe hekurudhor, me tarifa më të larta komisioni dhe fitimi. Raporti i lëkundshëm i tremujoreve 4 duke përjashtuar artikujt specifikë gjatë mesatares të likuiditetit tremujor të konsumuar ishte 2.43% në tremujorin e tretë të 2014 kundrejt 2.31% në tremujorin e tretë të 2013. Crédit Agricole CIB ruajti pozicion udhëheqës në sindikatën e biznesit në Francë (nr.1¹). Ajo gjithashtu u rendit e dyta në Europën Perëndimore dhe rajonin EMEA¹ në sindikatën e korporatës së kredisë në rajonin EMEA. Ajo u rendit e tret në rregullimin e projektit financiar në rajonin EMEA dhe gjithashtu ishin lider botëror në financat ajrore².

Të ardhurat nga tregu i kapitalit dhe investimet bankare ishin në vlerën e 390 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, duke përjashtuar ndikimin e DVA, një rritje me 4.0% vit pas viti.

Të ardhurat nga të hyrat fikse ishin 355 milion euro në tremujorin e tretë, një rritje me 6.9% vit pas viti, nxitur nga një performancë e mirë në thesar dhe një rritje e lehtë në aktivitetet e kredisë, duke kompensuar kështu rëniet e segmenteve të tjera, të cilat ishin penalizuar nga aktiviteti i ulët në Gusht.

CACIB ishte nr.1 në kontabilizimin e të konvertueshmeve në Francë¹ dhe letrave me vlerë europiane ABCP³. Ajo gjithashtu u rendit në vendin e 3^{te} ndër liderët botëror në çështjet e bonove mbikombëtare dhe mbajti vendin nr.3 në çështjet për agjensitë në euro¹. CACIB është lider në tregun e bonove⁴ të gjelbra me rregullimin e transaksioneve inovative: Abengoa (E para në Europë për politikën e gjelbër), MHB (ESG e parë në mbulimin e bonove), Banka Europiane e Investimit (12 vite në Bonot e Gjelbra) dhe transaksionet inaguruese të KfË (1.5 miliard euro) dhe Agjencia Franceze e Zhvillimit (1 miliard euro).

Të ardhurat nga investimet bankare ishin 35 milion euro, një rënie me 16.7% vit pas viti, kryesisht gjatë një muaji të dobët Gushti. CACIB ruajti vendin e tretë në marrëveshjet e kompletuara M&A me një pjesëmarrje franceze¹.

VaR mbeti shumë e ulët, në 5 milion euro më 30 Shtator 2014 (6 milion euro mesatarisht gjatë tremujorit të tretë të 2014).

Shpenzimet operative në Korporatën dhe Investimet bankare treguan një rritje vit pas viti me 1.6% në tremujorin e tretë të 2014.

Në tremujorin e tretë të 2014, një pagesë neto prej 65 milion euro u rezervua për koston e riskut, nën 127 milion euro në tremujorin e tretë të 2013. Kjo reflekton dispozita specifike jomateriale për një numër të kufizuar marrëveshesh.

Fitimi i aksioneve nga subjektet e kapitalit ishte 50 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, krahasuar me 35 milion euro në vitin e kaluar, kryesisht falë kontributit të Banque Saudi Fransi.

Të ardhurat neto nga ndërprerja dhe operacionet e mbajtura për shitje në tremujorin e tretë të 2013 përfshinë ndikimin e fitimit mbi dispozitat e CLSA dhe shitjeve të propozuara prej 50% të Grupit Newedge.

Korporata dhe Investimet Bankare dërguan të ardhura neto për pjesë nga Grupit të 245 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, pas rideklarimit për mbrojtjen e kredisë dhe ndikimin e DVA rrjedhëse.

¹ Burimi: Thomson Financial

² Burimi: Air Finance Database

³Burimi: CPWare

⁴Burimi: Climate Bond Initiative

6. KORPORATA QËNDRORE

<i>(në milion euro)</i>	T3-14	Ndryshimi T3/Q3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Të ardhurat <i>o/w kosto e fondeve</i>	(347) (637)	(30.6%) +19.2%	(1,483) (1,901)	(15.5%) +18.7%
<i>o/w Switch*</i>	(192)	+77.8%	(565)	+73.3%
<i>o/w menaxhimi financiar</i>	81	(53.1%)	259	x4.1
<i>o/w marzhi i emetimit</i>	65	nm	(220)	(59.6%)
<i>o/w tjetër</i>	144	+27.7%	379	+15.7%
Shpenzimet operacionale	(231)	(9.8%)	(652)	(2.4%)
Fitimi operacional bruto	(560)	(23.9%)	(2,135)	(11.9%)
Kosto e riskut	(65)	nm	29	(59.3%)
Fitimi operativ	(625)	(14.6%)	(2,106)	(10.4%)
Kapitali i filialeve	(9)	(8.7%)	(52)	(57.8%)
Fitimi neto nga aktive të tjera	(1)	+5.9%	82	(32.0%)
Fitimi para tatimit	(635)	(52.8%)	(3,047)	(35.2%)
Tatimi	306	(8.7%)	889	(3.3%)
Fitimi neto	(329)	(8.8%)	(1,189)	(18.9%)
Interesat jo-kontrolluese	22	(34.5%)	78	(33.0%)
Fitimi neto i Grupit	(351)	(10.9%)	(1,267)	(19.9%)

* Përfshirë shpërblimin nga aksioneri dhe T3CJ në tremujorin e tretë të 2013

Në tremujorin e tretë të 2014, të ardhurat arritën në -237 milion euro krahasuar me -500 milion euro në tremujorin e tretë të 2013. Ky tremujor përfshin koston e pjesëve 1 dhe 2 të Switch për -192 milion euro (-108 milion euro në tremujorin e tretë të 2013 duke përfshirë interesin e aksionerit dhe të T3CJ shënime në varësi, një mbrojtje më të mirë të riskut të inflacionit (e cila kushton 50 milion euro në tremujorin e tretë të 2013), përmirësimi strukturor në normën e interesit dhe ndryshimi në vlerë i bonove të kthyeshme të Eurazeo në aksione për 5 milion euro (-41 milion euro në tremujorin e parë të 2014 dhe +23 milion në tremujorin e dytë të 2014). Të ardhurat në tremujorin e tretë të 2013 u përfshinë artikujt e mëposhtëm të papërsëritur: +143 milion euro në fitimet e dispozitave Bankinter dhe +76 milion në fitimet në dispozitat e portofolit. Emetuesi i Crédit Agricole CIB dhe marzhet lidhur me kontratat e sigurimit të lidhura për njësi kishin një ndikim pozitiv prej 65 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me ndikimin negativ të -252 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, për tu krahasuar me -467 milion euro në tremujorin e tretë të 2013, duke përjashtuar marzhet e emetuesit, fitimin në dispozitat e Bankinter dhe fitimet në dispozitat e portofolit.

Shpenzimet operacionale ishin ulur me 9.8% në tremujorin e tretë të 2013 dhe 1.4% duke përjashtuar 20 milion euro dispozita të marra në tremujorin e tretë të 2013 për planin e nisjes vullnetare në Crédit Agricole Immobilier.

Kostoja e riskut ishte 65 milion euro, përfshirë pagesën për dispozita ligjore të përgjithshme.

Pjesa e Fitimit Neto të Grupit arriti në -351 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 dhe -393 milion euro duke përjashtuar ndikimet e marzhit të emetimit.

REZULTATET E KONSOLIDUARA TË GRUPIT CRÉDIT AGRICOLE

Kreditë konsumatore në total të Grupit ishin në vlerën e 705 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014. Bankat Rajonale, LCL dhe subjektet bankare ndërkombëtare me pakicë rritën depozitat e tyre Brenda bilancit me 2.8% vit pas viti në vlerën e 484 miliard euro në fund të muajit Shtator 2014. Në kushtet e financimit, depozitat konsumatore në bilanc ishin në vlerën e 625 miliard euro.

<i>(në milion euro)</i>	T3-14	Ndryshimi T3/T3	9M-14	Ndryshimi 9M/9M
Të ardhurat	7,550	+1.3%	22,896	+1.0%
Shpenzimet operacionale	(4,772)	+0.2%	(14,275)	+0.3%
Fitimi operacional bruto	2,778	+3.2%	8,621	+2.3%
Kosto e riskut	(684)	(17.1%)	(2,331)	(20.6%)
Fitimi operativ	2,094	+12.1%	6,290	+14.5%
Kapitali i filialeve	82	(11.8%)	(445)	nm
Fitimi neto nga aktive të tjera	4	nm	7	(58.8%)
Ndryshimi në vlerën e emrit të mirë	1	nm	-	(97.7%)
Fitimi para tatimit	2,181	+11.2%	5,825	+3.2%
Tatimi	(616)	(1.1%)	(1,999)	+11.7%
Fitimi neto nga operacionet jo të vazhdueshme ose të mbajtura për shitje	-	nm	5	nm
Fitimi neto	1,565	+2.8%	3,858	(5.8%)
Fitimi neto i Grupit	1,463	+2.1%	3,588	(6.6%)

Gjatë tremujorit të tretë të 2014, Grupi Crédit Agricole regjistroi të ardhura prej 7.550 milion euro, një rritje prej 1.3% krahasuar me tremujorin e tretë të 2013. Artikujt jo të lidhura me aktivitetet e biznesit (marzhi i emetuesit, drejtimi DVA dhe mbrojtjet e kredisë) ishin në vlerën +57 milion euro krahasuar me -299 milion euro në tremujorin e tretë të 2013, i cili përfshiu gjithashtu një fitim prej 143 milion euro në dispozitat e aksioneve të mbetura të Grupit në Bankinter.

Shpenzimet operative u rritën me 0.2% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2014, duke paraqitur 34 pikë bazë të vonesave të krahasuara me 40 pikë bazë në tremujorin e tretë të 2013. Rënia ishte veçanërisht e shënuar në bankingun me pakicë franceze dhe aktivitetet e financimit (shërbime financiare të specializuara dhe bankingun i korporatave dhe investues).

Pjesa e të ardhurave nga kapitali i filialeve ishte 82 milion euro në tremujorin e tretë të 2014, me një rënie prej 11.8% vit pas viti në tremujorin e tretë të 2013.

Fitimi neto i Grupit ishte 1,463 milion euro në tremujorin e tretë të 2014 krahasuar me 1,433 milion euro në tremujorin e tretë të 2013, një rritje prej 2.1% vit pas viti.

Informacioni financiar i Crédit Agricole SH.A për tremujorin e tretë të vitit 2014 përbëhet nga kjo deklaratë për shtyp dhe prezantimi i bashkëngjitur me të. Gjithë informacioni i rregulluar, duke përfshirë edhe dokumentin e regjistruar është e disponueshme në faqen e internetit: <http://www.credit-agricole.com/en/Investor-and-shareholder> pas “Financial Reporting” (Raportimit Financiar) dhe është publikuar nga Crédit Agricole SH.A në përputhje me parashikimet e nenit L. 451-1-2 të Kodit Monetar Financiar dhe nenit 222-1 të Rregullores së Përgjithshme të AMF.

Marrëdhëniet me shtypin	Marrëdhëniet e Investitorëve +33 (0) 1 43 23 04 31
Anne-Sophie Gentil +33 (0)1 43 23 37 51	Denis Kleiber +33 (0)1 43 23 26 78
Charlotte de Chavagnac +33 (0)1 57 72 11 17	Nathalie Auzenat +33 (0)1 57 72 37 81
Alexandre Barat + 33 (01) 43 23 07 31	Sébastien Chavane +33 (0)1 57 72 23 46
Louise Tingström +44 7899 066995	Fabienne Heures +33 (0)1 43 23 06 38
	Aleth Degrand +33 (0)1 43 23 23 81
	Marie-Agnès Huguenin +33 (0)1 43 23 15 99
	Laurence Gascon +33 (0)1 57 72 38 63
	Aurélie Marboeuf + 33 (0)1 57 72 38 05

Hegje dorë nga përgjegjësia

Shifrat e paraqitura në nëntë muajt e parë të 2014 janë përgatitur në përputhje me IFRS të përshtatur me Bashkimin Europian dhe e zbatueshme në atë datë.

Informacioni financiar nuk përcakton një sërë pasqyrash financiare për një periudhë të përkohshme siç përcaktohet nga IAS 34 “Raportimi financiar i përkohshëm” dhe nuk është kontrolluar.

Ky prezantim mund të përfshijë një informacion me perspektivë për Grupin, caktuar si informacion mbi tendencat. Kjo e dhënë nuk përfaqëson parashikimet brend kuptimit të Rregullores 809/2004 të Bashkimit Europian të datës 29 Prill 2004 (kapitulli 1, neni 2/10). Ky informacion u përpilua nga skenare të bazuar në një numër supozimesh ekonomike për një konkurrencë të caktuar dhe mjedis rregullator. Për këtë arsye, këto supozime janë nga natyra faktorë të rastësishëm të cilët mund të shkaktojnë rezultate aktuale për të ndryshuar nga projeksionet.

Gjithashtu, pasqyrat financiare bazohen në vlerësime, veçanërisht në llogaritjen e vlerës së tregut dhe vlerësimin e aktiveve. Lexuesit duhet të marrin në konsideratë të gjithë këto faktorë risku dhe pasigurie para se të japin gjykimin e tyre.